

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, me praktikanten Edona Selimi, në lëndën penale kundër të akuzuarve E.K. dhe F.V., për veprën penale, **Sulmi nga neni 187 parag. 1 i KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm PP.II. Nr. 1689/2016 të datës 10.10.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, më datën 26.04.2018, mori dhe në prezencë të palëve shpalli, kurse më datë 08.05.2018 përpiloi këtë:**

A K T G J Y K I M

1. I akuzuari E.K., nga babi Sh. dhe nëna R., e lindur M., i lindur me date ... ne ..., jeton ne fshatin ..., Komuna e ..., i pa martuar, ka te kryer shkollen e mesme, i gjendjes se mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikes se Kosoves, i pa denuar me pare dhe nuk zhvillohet procedure tjeter penale ndaj tij.
2. I akuzuari F.V., nga babai Z. dhe nëna R., e lindur S., i lindur me date ..., ne ..., jeton ne fshatin ..., Komuna e ..., i pa martuar, kamarier, ka te kryer shkollen e mesme, i gjendjes se mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikes se Kosoves, i pa denuar me pare dhe nuk zhvillohet procedure tjeter penale ndaj tij.

JANË F A J T O R Ë

Sepse,

I. 1. I akuzuari E.K., me date 12.09.2016, rreth ores 19:00 min, ne fshatin ..., i akuzuari i ka sulmuar te demtuarit P.Sh. dhe S.A., ne ate menyre derisa i akuzuari se bashku me te mturin A.K., ishin para shtepise se tij, aty kishte kaluar i akuzuari F.V., se bashku me te miturit S.A., S.K., A.Sh., P.Sh.i dhe K.V., te cilet fillimisht kishin komunikuar me fjale fyese mes veti, e me pastaj i akuzuari E., e perdorë forcen dhe me grusht ne fytyre i sulmon te demtuarit P.Sh. dhe S.A.,

-me çka ka kryer veprën penale, **Sulmi nga neni 187 parag. 1 i KPRK-së,**

II. 2. I akuzuri F.V., me date 12.09.2016, rreth ores 19:00 min, ne fshatin ..., ka sulmuar te demtuarin – te akuzuarin E.K., ashtu qe pasi ishin fjalosur ne menyren si ne dispozitivin I te ketij aktgjykimi, i akuzuari e ka marre nje guri rreth 20-30 cm gjuan ne drejtim te te akuzuarit E.K., por nuk arrinë ta godas,

- me cka ka kryer vepren penale **Sulmi nga neni 187 parag. 1 i KPRK-së.**

**I G J Y K O N
ME DËNIM ME KUSHT**

Dënim Burgu në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse te akuzuarit në kohën prej **1 (një) viti**, nuk kryejnë veprën tjetër penale, në të kundërtën gjykata dënimit me kusht do ta revokojë.

Obligohen te akuzuarit që të paguajnë **paushallin gjyqësor** në shumë prej **20 (njëzet) €**, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit, **udhëzohen në kontest juridiko-civil**, për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan,- Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP.II.nr. 1689/2016, të datës 10.10.2016, kundër të akuzuarve E.K. dhe F.V., për shkak të veprës penale **Sulmi nga neni 187 paragraf. 1 i KPRK-së** dhe ka kërkuar që të njëjtit t'i shpallë fajtor dhe t'i dënojë sipas ligjit.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datë 03.04.2018, pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit Bahtije Ademi, të akuzuarit E.K. dhe F. V., kanë deklaruar se e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohen, duke deklaruar se e pranojnë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, pas dëgjimit të palëve, ka aprovuar pranimin e fajësisë nga të akuzuarit E.K. dhe F.V., ngase ka ardhur në përfundim se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë të parapara në nenin 248 paragrafi 4 të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë drejtim, sipas vlerësimit të gjyqtarës së vetme gjykuese, të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret, të cilat janë paraqitur së bashku me aktakuzë dhe nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafi 1 të KPPK-së.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, erdhi në përfundim se të akuzuarit E.K. dhe F.V., kanë kryer veprën penale e cila u vihet ne barrë.

Me rastin e caktimit dhe llojin e lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se të akuzuarit patën sjellje korrekte në Gjykatë, se janë penduar për veprat në fjalë, ndërsa, si rrethanë rënduese, mori shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, me bindje se edhe menjë dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK -së.

Nga të cekurat më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

*Praktikantja,
Edona Selimi*

*Gjykatësja e vetme gjykuese,
Luljete Shabani*

***KESHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.*